



Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 datë 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 29.06.2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
SË LIPJANIT**

Neni 1

MIRATOHET, oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1. "Gërlica Company sh.p.k"-Magjistranja Babush i Ri, rr."Xhevë Lladrovci"-Ferizaj, është shfrytëzues i pronës të paluajtshme të Komunës.
2. Prona e paluajtshme të Komunës, gjindet në Zonën kadastrale Gadime e Ulët, si në vijim:

Nr	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²
1	Pasuri shtet Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409028-01049-6	Gadime e Ulët	Bujqësore- kullosë kl.6- të	40000

3. Shfrytëzimi i pronës do të jetë 16 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
4. Në pronën e cekur do të ushtrohet veprimtaria: shfrytëzimi i shkëmbinjëve-seperim të gurëve, apo të ngjajshme sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.

Neni 2

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajshme të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso-ro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspektoratit dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 463-26361

Lipjan, më 29. 06. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

